ADMINISTRATA MBËSHTETËSE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT (AUTORITET PUBLIK)

Administrata e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përbëhet nga Sekretari i Përgjtihshëm dhe dy drejtori, Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve, Marrëdhënieve me Median e Publikun dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse.

Funksioni drejtues	**Detyrat dhe përgjegjësitë**
Sekretari i Përgjithshëm Z. Edmond Verçani e-mail: Edmond.Vercani@kpk.al	Është përgjegjës për administrimin e të gjitha çështjeve që kanë lidhje me administratën, duke programuar, planifikuar dhe monitoruar ato me qëllim përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit; përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të palët e treta, në rastet kur Kryetari i KPK-së është në pamundësi për ta kryer këtë detyrë; asiston kryetarin për procedurat e shortit dhe administron regjistrin e dosjeve; bashkërendon dhe koordinon punën midis komisionerëve dhe strukturës administrative në varësi; organizon dhe drejton punën për planifikimin e zbatimin e buxhetit, si dhe e përditshme të personelit administrativ; trajton cështjet në marrëdhëniet me publikun; organizon punën për përgatitjen e raportit vjetor për shpenzimet financiare; rekruton stafin administrative, organizon e merr masat për mbarëvajtjen e punës.
Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve, Marrëdhënieve me Median & Publikun Znj. Albana Pulaj, Drejtor e-mail: Albana.Pulaj@kpk.al	Bashkërendon punën me qëllim menaxhimin e çështjeve që do të shqyrtohen nga KPK-ja sipas ligjit, përkthimin e proceseve, akteve procedurale dhe vendimeve që merren nga komisionerët, dhënen e informacionit medias dhe publikut, marrjen e administrimin e ankesave të paraqitura nga subjektet e rivlerësimit; kontribuon në hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ose të kontratave ku KPK është palë; përfaqëson Komisionin para organeve gjyqësore dhe administrative në rast konflikti.
Koordinatori për Mediat Znj. Joniada Koçi, Koordinator e-mail: Joniada.Koci@kpk.al	Realizon komunikimin dhe informacionet me interes për publikun dhe mediat vizive, të shkruar dhe online, duke i mundësuar atyre të drejtën për t'u njohur me informacionin publik në mëmyrë transparente, korrekte e të besueshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse Z. Agim Paskali, Drejtor e-mail: Agim.Paskali@kpk.al	Është përgjegjese për administrimin e çdo veprimtarie ekonomiko-financiare dhe administrative në fushën e burimeve njerëzore, TIK-ve, si dhe shërbimeve mbështetëse, me qëllim mirëfunksionimin e institucionit; harton projektbuxhetin dhe detajon planin e buxhetor, planifikon shpenzimet sipas strukturës buxhetore dhe detajon planin në përputhje me legjislacionin buxhetor/financiar në fuqi.